

URDHËR
Nr. 82, datë 16.2.2023

**PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME
PATOGENITET TË LARTË TË SHPENDËVE, TË SHFAQUR NË SHTETIN E
BULLGARISË**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 e Kushtetutës, neni 43, i ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, “Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe informacioni i përditësuar, i marrë nga faqja zyrtare e Organizatës Ndërkombëtare të Mbrojtjes së Shëndetit të Kafshëve (OIE),

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, tranzitimit nëpërmjet territorit të Republikës së Shqipërisë, të:
 - a) shpendëve të gjallë shtëpiakë dhe të egër;
 - b) zogjtë 24 orësh;
 - c) shpendë dekorativë;
 - ç) materialit biologjik të shpendëve;
 - d) vezët e shpendëve;
 - dh) mishi i shpendëve;
 - e) nënproduktet e shpendëve.
- Nga shteti i Bullgarisë sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Ndarja administrative e nivelit 1	*Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
1.	Sofia	Etropole	

Shënime. Simboli () nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.*

2. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.
 3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë dhe të egër, zogjtë 24 orësh, shpendë dekorativë, materialit biologjik, vezët e shpendëve, mishi i shpendëve dhe nënproduktet e shpendëve që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 1.
 4. Urdhri nr. 489, datë 24.10.2022, “Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Bullgarisë”, shfuqizohet.
 5. Për zbatimin e këtij urdhri, ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Frida Krifca